



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

**REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS VITI**

Nr.01. \_\_\_\_\_  
Viti: 06.06.2011

Pranor - Prerjedje MeDena 09-06-2011			
Nr./organi Org./broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
01-013/802 -			

Në mbështetje të dispozitave të nenit. 12 paragrafi 2. shkronja d nenit 17 shkronja c lidhur me nenin nr.58 shkronja g dhe h të . Ligji për Vetqeverisjen Lokale nr.03/L-40 ( gaz. Zyrtare 28/2008),si dhe ne mbështetje me dispozitat e nenie 9 par.1dhe 2, të ligjit për dhënjën në shfrytzim dhe kembimin e pronës se paluajtshme te komunes nr.03./L-226, sidhe konform dispozitave te nenit 36 parag.2 pika 2 lidhur me nenin 50 parag 1 shkronja i , Kuvendi i Komunës së Vitise me 06.06.2011 miraton këtë:

**V E N D I M**

**PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM për ngastrat kadastrale nr. 2059/10, 2485, 2495, 969/1, 2496/1, 2496/2, 2484/1, 2484/11, 2484/12, 3461/1, 3461/50, 2487/1, 2487/11, 968/0 në zonen kadastrale Viti, dhe ngastrat nr.596/1, 596/2, 596/3, 576, 443/2 ne z.k. Drobesh.**

**Neni 1.**

Me këtë Vendim shpallet interesi i pergjithshem për ngastrat e lartë cekura me qëllim të ndërtimit të objekteve me rëndësi të domosdoshme dhe funksionale për realizimin e interesave te pergjithshme-publike për qeshtjet e Komunës së Vitisë, dhe të nevojave për ushtrimin e kompetencave komunale në përgjithesi .

**Neni 2.**

Ngastrat kadastrale të lartëcekura që janë objekt i këtijë Vendimi janë në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore nën menagjim të AKP-së , dhe të cilat kanë sipërfaqe të ndryshme.

**Neni 3.**

Pjesë përbërse e këtijë Vendimi do të jetë dokumentacioni kadastral për ngastrat, si në dispozitiv të këtijë vendimi.

**Neni 4.**

Për zbatimin e këtijë Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi në Viti.

**Neni 5.**

Për mbikqyrjen e realizimit të këtijë Vendimi do te kujdeset Kryetari i Komunes së Vitisë.

**Neni 6.**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunes së Vitisë,firmosjes dhe protokolimit zyrtarë të tijë.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë

Z. Skenderbe Hebibi